

Roli i parlamenteve të Serbisë dhe Kosovës në normalizimin e marrëdhënieve

Hyrje

Këshilli për Qeverisje Inkluzive (CIG) ka organizuar më 25 prill 2015, në Beograd tryezën e dytë të rumbullakët për anëtarët e parlamenteve të Serbisë dhe Kosovës. Takimi i parë është mbajtur në Prishtinë, në dhjetor të vitit 2014. Diskutimet kanë adresuar rolin e përgjithshëm të parlamenteve në normalizimin e marrëdhënieve mes serbëve dhe shqiptarëve, me fokus të veçantë në implementimin e marrëveshjes së Brukselit të prillit të vitit 2013. Nga Serbia, pjesëmarrësit kanë qenë nga Partia Progressive Serbe, Partia Socialiste e Serbisë, Partia Demokratike, Partia Social-Demokrate dhe Partia për Aksion Demokratik; kurse nga Kosova, pjesëmarrësit kanë qenë nga Partia Demokratike e Kosovës, Lidhja Demokratike e Kosovës, Lëvizja Vetëvendosje, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, Lista Serbe, si dhe përfaqësues të Parlamentit të Zvicrrës, Ambasadës së Zvicrrës në Serbi, dhe Departamentit Federal për Punë të Jashtme të Zvicrrës.

Takimi ka qenë pjesë e një projekti për normalizimin e marrëdhënieve mes Kosovës e Serbisë i cili financohet nga Departamenti Federal i Punëve të Jashtme i Zvicrrës.

Ka ekzistuar një konsensus se implementimi i marrëveshjes së Brukselit duhet të përshpejtohet. Pjesëmarrësit serbë kanë thënë se Prishtina është duke e vonuar implementimin e pjesëve të marrëveshjes të cilat kanë rëndësinë më të madhe për serbët, posaçërisht krijimi i Asociacionit/Komunitetit të komunave me shumicë serbe (më tej referuar si Asociacioni/Komuniteti), kurse pjesëmarrësit nga Kosova kanë thënë se Beogradi nuk e ka shpërbërë sistemin e tij në Kosovë i cili, sipas tyre, është një parakusht, i paraparë edhe në marrëveshje, për krijimin e Asociacionit/Komunitetit. Disa kanë propozuar që shpërbërja e sistemit serb në Kosovë dhe krijimi i Asociacionit/Komunitetit të ndodhin paralelisht.

Shumë nga pjesëmarrësit kanë thënë se implementimi i marrëveshjes së Brukselit më shumë ka të bëjë më kohën e hapave që duhet të ndërmerren, sesa substancën e tyre: Beogradi është pajtuar për shpërbërjen e strukturave paralele, por është duke refuzuar ta bëjë këtë derisa Prishtina të pajtohet rreth krijimit të Asociacionit/Komunitetit; kurse Prishtina është pajtuar rreth Asociacionit/Komunitetit, por është duke refuzuar të angazhohet në krijimin e tij deri kur Beogradi ta shpërbëjë sistemin e tij në Kosovë. Sipas

të gjitha gjasave, krijimi i Asociacionit/Komunitetit përballë shpërbërjes së sistemit të Serbisë do të mbesin edhe më tej pjesë e pazarit në tavolinën e negociatave të mëtejme.

Ky raport ofron një pasqyrë të përgjithshme të diskutimeve. Për të inkurajuar një diskutim të hapur, takimi është mbajtur nën rregullat e Chatham House, ku ato që thuhet gjatë diskutimeve nuk u atribuohen folësve specifik. Nënpresidenti i CIG Shpetim Gashi e ka përgatitur këtë raport dhe CIG merr përgjegjësinë për përmbajtjen e tij.

Normalizimi pa njohje

Mosmarrëveshja rreth statusit mbetet pengesa kryesore në normalizimin thelbësor të marrëdhënieve mes Serbisë dhe Kosovës. Kjo është reflektuar edhe gjatë diskutimeve. Pothuasje të gjithë pjesëmarrësit nga Kosova kanë thënë se normalizimi i marrëdhënieve do të jetë i vështirë për aq kohë sa Beogradi të mos e pranojë pavarësinë e Kosovës. “Nuk mund të ndërtoni marrëdhënie normale me një fqinj i cili pretendon ta marrë shtepinë tënde. Së pari, fqinji duhet ta njohë të drejtën tënde pronësore të shtëpisë, e pastaj mund të bëhemi miq”, ka thënë një pjesëmarrës.

Pjesëmarrësit serbë kanë thënë se njohja e Kosovës nga Serbia nuk do të ndodhë, së paku jo në një periudhë të afërt. Duke marrë parasysh këtë dilemë, pjesa më e madhe e folësve kanë favorizuar qasjen ekzistuese të normalizimit hap pas hapi, duke u marrë së pari me fushat ku marrëveshjet janë të mundshme, e jo duke e ndalur dialogun në tërësi derisa Serbia ta njohë Kosovën. Për ndryshim nga takimet tjera me pjesëmarrësit e rregullt të CIG, parlamentarët gjatë diskutimeve i janë referuar Kosovës si “Republika e Kosovës”, apo në anën tjetër, “Kosova e Metohija”.

Deputetët mund të luajnë një rol thelbësor sidomos në promovimin e pajtimit dhe tolerancës mes dy shoqërive. Shumë folës kanë theksuar se marrëdhëniet mes shoqërive të tyre ndikohen nga e kaluara e vështirë dhe nga paragjykimet dhe opinionet negative për tjetrin. Edhe gjenerata e lindur pas luftës ka opinion negativ ndaj kosovarëve ose serbëve. Ky opinion nuk bazohet në përvojë vetanake, por në narativa të ndryshme. Kjo duhet të adresohet dhe parlamentarët, duke pasë parasysh lidhjet e tyre të afërta me votuesit, do të mund të kontribuonin në këtë drejtim, duke iniciuar ndryshime në sistemin e arsimit, posaçërisht në lidhje me tekstet shkollore të historisë, në organizimin e shkëmbimeve kulturore mes studentëve dhe promovimin e një fushatë të përgjithshme të tolerancës. Të dyja shoqëritë duhet ta njohin atë që ka ndodhë, ta marrin pjesën e tyre të përgjegjësive dhe të marrin hapa për t’u dhënë drejtësi viktimave. “Përndryshe, femijët tanë do të dëgjojnë vetëm storie të urrejtjes, storie se si në rajonin tonë krimet nuk ndëshkohen dhe rrjedhimisht do ta urrejnë njëri-tjetrin.”

Serbia dhe Kosova do të duhej të fokusoheshin më shumë në bashkëpunimin ekonomik dhe në fushën e biznesit. Një folës ka theksuar se bashkëpunimi ekonomik është më pak i ndjeshëm dhe si i tillë, ka më shume gjasa për të pasur sukses. “Në politikë, akterët përfitojnë duke krijuar pengesa dhe probleme, në biznes dhe ekonomi, akterët përfitojnë duke i larguar po të njëjtat barriera”, ka thënë një folës. Procesi i dialogut të Brukselit është i rëndësishëm në vendosjen e një bashkëpunimi politik mes dy qeverive, dhe në zbutjen e

tensioneve mes dy shoqërive, mirëpo normalizimi i vërtetë kërkon eliminimin e pengesave në tregti, liri të plotë të lëvizjes, si dhe njohje të sistemeve arsimore dhe të diplomave të njëri tjetrit. Kjo e fundit do të ndihmonte posaçërisht shqiptarët në jug të Serbisë, pasi që një numër i madh i tyre kanë diploma nga universitetet e Kosovës. Por pjesëmarrësit janë pajtuar që normalizimi politik është parakusht për bashkëpunimin social dhe ekonomik.

Dialogu i Brukselit ka shërbyer si një instrument i dobishëm në ndërprejren e status quo-së, sidomos në veri të Kosovës. Implementimi nuk ka qenë shumë i lehtë, por një pjesëmarrës ka thënë se askush nuk ka parashikuar një proces të lehtë, duke shtuar se pjesa më e rëndësishme është që procesi ka fituar pëlqimin dhe miratimin e të dy popujve, si në Serbi ashtu edhe në Kosovë. “Njerëzit në Kosovë dhe Serbi i vënë në pikëpyetje rezultatet e dialogut, por ata e përkrahin atë si një instrument për normalizimin e marrëdhënieve”. Ai ka shtuar se bashkëpunimi do të duhej të shtrihej në fushat që kanë të bëjnë me integrimet evropiane dhe qeverisjen lokale, ku bashkëpunimi është më pak i ndjeshëm.

“Kalimet e kufirit mes Kosovës dhe Serbisë janë më të këqinjta në Evropë”, ka thënë një pjesëmarrës. “Koha që duhet për tu marrë me dokumentet e udhëtimit, zëvendësimi i tabelave të veturës të Kosovës me tabela të përkohshme të Serbisë, si dhe çmimi i lartë i sigurimit të veturës (veturat e Kosovës duhet të paguajnë rreth 135 euro për një muaj, kurse serbët paguajnë rreth 20 euro për dy javë), janë barrë shtesë jo vetëm për buxhetin personal, por poashtu krijojnë një ndjenjë se jeni duke hyrë në territor armiqësor”. Parlamentarët u kanë bërë thirrje Beogradit dhe Prishtinës ti lehtësojnë procedurat e kalimit të kufirit dhe të eliminojnë “pagesat kriminale të sigurimit”. Disa folës kanë thënë se nga pagesa e sigurimeve përfitojnë vetëm kompanitë e sigurimeve në Serbi dhe në Kosovë të cilat vazhdojnë “ti vjedhin në mënyrë legale qytetarët e tyre”. Ata poashtu kanë përkrahur idenë e një marrëveshjeje për të hequr pagesat shtesë për telefoni mobile jashtë vendit (roaming), si dhe një marrëveshje të përgjithshme rreth telekomunikacionit. Të ballafaquar drejtpërdrejt me këto pengesa dhe pasi që ishte dashur të prisnin për rreth tri orë në kufi për shkak të keqkuptimeve rreth çështjeve logjistike, deputetët e parlamentit të Kosovës kanë thënë se marrëveshja e Brukselit mbi lëvizjen e lirë nuk është e mjaftueshme dhe duhet të rinegociohet, ose në të kundërtën, Prishtina duhet të aplikojë masa reciproke, kanë thënë disa nga pjesëmarrësit.

Ekzistojnë shumë çështje jopolitike ku Beogradi dhe Prishtina do të mund të shënonin progres thelbësor. Një folës serb ka propozuar që kryetarët e komunave të Kosovës të krijojnë kushte më të mira për kthimin e refugjatëve serbë të Kosovës, Prishtina të respektojë kuotat e punësimit për komunitetet pakicë, dhe ligji mbi gjuhët të implementohet më mirë. Këto janë çështje nuk lidhen me statusin por me sundimin e ligjit në Kosovë.

“Pesonat e zhdukur” është një çështje tjetër e cila do të mund të ishte zgjidhur po të kishte më shumë vullnet politik. Një folës nga Kosova ka thënë se vetëm javën e kaluar janë varrosur mbetjet e 28 personave të zhdukur në fshatin e saj, kurse 16 ende mbesin të pagjetur. “Deria të mos hedhim dritë mbi të kaluarën, do të vazhdojë të na ndjekë pas. Ne nuk mund të kemi marrëdhënie normale kur edhe 15 vite pas luftës ende varrosim njerëz”. Janë ende rreth 1700 persona të pagjetur, prej të cilëve rreth 400 janë serbë.

Edhe çështja e personave të zhdukur është ndarë në vija etnike. Ekzistojnë dy memoriale në nderim të të zhdukurve, një në Prishtinë për shqiptarët, dhe një në Graçanicë për serbët. Në diskursin publik përmenden vetëm personat e zhdukur nga njëri komunitet. Vitin e kaluar parlamenti i Kosovës ka miratuar rezolutën për personat e zhdukur, por siç ka thënë një folës, Beogradi nuk mund ti gjejë serbët e zhdukur, dhe së këndejmi, një kushtëzim i tillë do të kishte kuptim vetëm nëse Prishtina do ta kishte kryer detyrën e saj në gjetjen e tyre”. Një tjetër folës ka thënë se “është hipokrite se si shqiptarët kërkojnë që Beogradi t’i gjejë të zhdukurit nga komuniteti i tyre, por nuk i bëjnë një kërkesë të tillë qeverisë së tyre për gjetjen e serbëve të zhdukur. Është po aq hipokrite se si serbët kërkojnë nga Prishtina të gjejë serbët e zhdukur, por një kërkesë të tillë nuk ia parashtrorjnë qeverisë së tyre për të gjetur shqiptarët e zhdukur”.

Miqhtë e normalizimit

Një folës ka thënë se deputetët e Serbisë dhe Kosovës do të duhej të krijonin një grup që do të thirrej “Miqhtë e Normalizimit”. Parlamentet e Kosovës dhe Serbisë tashmë kanë grupe të miqve me parlamentet e shteteve tjera. Shumica e pjesëmarrësve kanë përkrahur këtë propozim, por disa kanë thënë se ky grup nuk do të mund të funksionojë për aq kohë sa parlamenti i Serbisë nuk e pranon parlamentin e Kosovës si një institucion i një shteti të pavarur. “Grupe të tilla mund të ekzistojnë vetëm mes të barabartëve. Nëse deputetët e Serbisë mund të na llogarisin si të barabartë, atëherë do të mund ta formojmë këtë grup”. Edhe pse një njohje e tillë ka pak gjasa të vijë nga deputetët serbë, një folës serb ka thënë se ky grup do të mund të ndihmonte në zbutjen e tensioneve dhe në ndërtimin e një momentumit për iniciativa të reja dhe se ky grup do të shërbente për të bërë dialog, e jo negociata.

Normalizimi i marrëdhënieve është duke ndodhur, me ose pa njohjen e Kosovës nga Serbia. Shumë pak njerëz kanë pritur që takime mes parlamentarëve të Kosovës e Serbisë dhe ministrave të të dyja vendeve do të mund të mbaheshin në Prishtinë e Beograd vetëm shtatë vite pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Shumë nga këto takime as që lehtësohen nga komuniteti ndërkombëtar.

“Normalizim do të thotë atëherë kur serbët të flasin për diskriminimin e shqiptarëve në Serbi, dhe kur shqiptarët të flasin për diskriminimin e serbëve në Kosovë, dhe jo e kundërta, siç po ndodhë në këtë takim”, ka thënë një pjesëmarrës.

Parlamentet si kontrollues të pushtetit apo makina të votimit

Serbia dhe Kosova janë demokraci parlamentare, por në të dyja vendet, parlamentet janë të dobëta. Lojaliteti i parlamentarëve tenton të anojë kah udhëheqësi i partisë, e jo në anën e votuesit, duke qenë se udhëheqësi i partisë është ai që vendosë se kush do të jetë në listat zgjedhore. Disa folës kanë thënë se parlamentet e Kosovës e Serbisë shërbejnë thjesht si “makina të votimit”. Një folës nga Kosova ka thënë se qeveria e Kosovës ka përjashtuar parlamentin nga procesi negociator me Serbinë, dhe përkundër kësaj, parlamenti ka ratifikuar marrëveshjen e Brukselit, me shumë pak pyetje të parashtruara. Disa folës serbë

kanë thënë se një gjendje e ngjajshme është edhe në parlamentin e tyre. “Në Serbi është edhe më keq pasi që një parti politike ka shumicën absolute. Partitë opozitare nuk kanë shumë ndikim”.

Një folës ka thënë se zakonisht ka presion nga ekzekutivi që të votohet ndonjë legjislacion i caktuar dhe të përkrahen iniciativa të caktuara, por poashtu ekziston një nivel i lartë i vetëcenzurës. “Në nuk mund gjithmonë ti themi gjërat të cilat duam ti themi pasi që ato mund të mos u pëlqejnë udhëheqësve të lartë të partisë”. Pasi që udhëheqësi i partisë vendosë se kush do të bëhet deputet, deputetët nuk ndijnë lojalitet ndaj vetë institucionit. Kjo gjendje është më e theksuar në Serbi sesa në Kosovë, duke marrë parasysh sistemin e listave të mbyllura.

Duke marrë parasysh rolin dhe influencën e dobët të parlamenteve, një folës ka thënë se parlamentet as që do të duhej të flisnin për dialogun e Brukselit, pasi që qeveritë as që konsultohen me ta. “Si deputetë, ne shpesh marrim vesh për vendime të caktuara përmes mediave, përfshirë edhe vendimet për të cilat në jemi përgjegjës”. E njëjta ka ndodhur edhe me dialogun. “Rrjedhimisht, unë nuk dua ta respektoj një proces i cili nuk më respekton as mua, e as institucionin tim”.

Përfundim

Pjesëmarrësit kanë propozuar që deputetët e Serbisë dhe Kosovë, do të duhej ta ngrisin bashkëpunimin mes vete përmes takimeve joformale; takimeve të komisioneve parlamentare; ngjarjeve kulturore e sportive, p.sh. lojë futbollit mes anëtarëve të të dy parlamenteve; si dhe në bashkëpunim mbi çështjet e integriteteve evropiane. Anëtarët e të dyja parlamenteve kanë thënë se përkundër mosmarrëveshjes rreth statusit, është në interes të të dyja shoqërive që të avancojnë në rrugën e tyre të integritetit evropian dhe se asnjëra palë nuk duhet ta pengojë palën tjetër.

Pjesëmarrësit kanë rekomanduar që Beogradi dhe Prishtina ta përshpejtojnë implementimin e marrëveshjes së Brukselit, sidomos me qëllim të zgjidhjes së çështjeve që ndikojnë në jetën e përditshme të njerëzve, përfshirë uljen e pagesës së sigurimit të veturës dhe njohjen e diplomave universitare. Ata kanë shprehur përkushtimin e tyre që të angazhohen më shumë për të ndihmuar në arritjen dhe implementimin e marrëveshjeve mbi arsimin, kompletimin e marrëveshjes mbi lirinë e lëvizjes, dhe në formimin e grupit “Miq të Normalizimit”. Ky grup do të ndërtonte momentum dhe përkrahje për hapat të cilat të dyja qeveritë duhet ti ndërmarrin për normalizimin e marrëdhënieve.

Duhet poashtu të ketë më shumë bashkëpunim për çështjen e personave të zhdukur, dhe të dyja shoqëritë do të duhej ti pranonin përgjegjësitë dhe obligimet e tyre për zgjidhjen e kësaj çështjeje. Pjesëmarrësit kanë thënë se ata do ti inkurajojnë qeveritë e tyre për të bërë më shumë në gjetjen e personave të zhdukur dhe janë pajtuar që ta adresojnë këtë çështje në takimet e radhës.

Pjesëmarrësit janë pajtuar që takimi i radhës të mbahet gjatë kësaj vere në Prishtinë.

Pjesëmarrësit

Sipas alfabetit të gjuhës angleze

Besim Beqaj, Anëtar i Parlamentit të Kosovës, Partia Demokratike e Kosovës
Gordana Comic, Anëtare e Parlamentit të Serbisë, Partia Demokratike
Aida Corovic, Anëtare e Parlamentit të Serbisë
Ilir Deda, Anëtar i Parlamentit të Kosovës, Këvizja Vetëvendsoje
Blerta Deliu Kodra, Anëtare e Parlamentit të Kosovës, Partia Demokratike e Kosovës
Sadri Ferati, Anëtar i Parlamentit të Kosovës, Lidhja Demokratike e Kosovës
Riza Halimi, Anëtar i Parlamentit të Serbisë, Partia për Aksion Demokratik
Teuta Haxhiu, Anëtarë e Parlamentit të Kosovës, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës
Lirije Kajtazi, Anëtare e Parlamentit të Kosovës, Lidhja Demokratike e Kosovës
Bardhyl Metaj, Anëtar i Parlamentit të Kosovës, Lidhja Demokratike e Kosovës
Ganimete Musliu, Anëtare e Parlamentit të Kosovës, Lidhja Demokratike e Kosovës
Vladimir Orlic, Anëtar i Parlamentit të Serbisë, Partia Progressive Serbe
Krstimir Pantic, Anëtar i Parlamentit të Serbisë, Partia Progressive Serbe
Slobodan Petrovic, Anëtar i Parlamentit të Kosovës, Lista Serbe
Dejan Radenkovic, Anëtar i Parlamentit të Serbisë, Partia Socialiste e Serbisë
Branko Ruzic, Anëtar i Parlamentit të Serbisë, Partia Socialiste e Serbisë
Janko Veselinovic, Anëtar i Parlamentit të Serbisë, Partia Social-demokrate
Vanja Vukic, Anëtar i Parlamentit të Serbisë, Partia Socialiste e Serbisë
Shpetim Gashi, Nënpresident, Këshilli për Qeverisje Inkluzive
Alex Roinishvili Grigorev, President, Këshilli për Qeverisje Inkluzive
Arber Kuci, Bashkëpunëtor, Këshilli për Qeverisje Inkluzive
Christa Markwalder, Nënkryetare, Parlamenti i Zvicrës, FDP.Die Liberalen
Igor Novakovic, Bashkëpunëtor, Këshilli për Qeverisje Inkluzive
Jean-Daniel Ruch, Ambasador i Zvicrës në Serbi
Talia Wohl, Zyrtare e Programit, Departamenti Federal i Punëve të Jashtme i Zvicrës